



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Sektori Juridik

Nr. Prot.

DATA 03.06.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 03.06.2025

Drejtuar: “OUEN”sh.p.k me adrese Lagjia Shemri,rruga nacionale shemrikukues km2,zona kadastrale nr.3335,numir pasurise 593/1

Operatorit Ekonomik (OE) x ose

“OUEN”sh.p.k, K17529215O me adrese Lagjia Shemri,rruga nacionale shemrikukues km2,zona kadastrale nr.3335,numir pasurise 593/1

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **x**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **x**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Pune

Lloji i Procedurës së prokurimit:E hapur Pune

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 45307-04-16-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Rikonstruksion e Tregut Agrikulturor ,Bashkia Puke per nje afat nga lidhja e kontrates 4 muaj*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:17.04.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike[22.04.2025][20]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **x**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. B.O.E “Progres Shkodra”sh.p.k M17324001D & “Shijaku”sh.p.k J64102272V

Vlera 13,431,963 (Trembedhjetemilion e katerqinde e tridhjetë e njemije e nenteqinde e gjashtedhjetë e tre) leke pa tvsh

2. B.O.E “AHK-NY”sh.p.k M22302033N & “B-93”sh.p.k J62903508R

Vlera 13,952,376 (Trembedhjetemilion e nenteqinde e pesedhjetë e dymije e treqinde e shtatedhjetë e gjashtë) leke pa tvsh

3. “Nika”sh.p.k J76705047U

Vlera 14,340,649.26 (Katermbledhjetemilion e treqinde e dyzetmije e gjashteqinde e dyzet e nente pike njetzet e gjashtë) leke pa tvsh

4. “Asi Invest”sh.p.k M01927023H

Vlera 15,960,313.50 (Pesembledhjetemilion e nenteqinde e gjashtedhjetemije e treqinde e trembedhjetë pike pesedhjetë) leke pa tvsh

5. “OUEN”sh.p.k K17529215O

Vlera 20,601,321.39 (Njetzetmilion e gjashteqinde e njemije e treqinde e njetzet e një pike tridhjetë e nente) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. B.O.E “Progres Shkodra”sh.p.k M17324001D & “Shijaku”sh.p.k J64102272V

Operatorët ekonomikë kanë marrë pjesë si Bashkim i Përkohshëm i Operatorëve ekonomikë formalizuar me Akt Marrëveshjen e datës 09.05.2025 nënshkruar mes tyre.

Sipas kësaj akt marrëveshje palët e mësipërme kanë rrënë dakort që të marrin pjesë në këtë bashkim dhe të realizojnë zërat e punimeve 29 % për subjektin Progres Shkodra shpk dhe 71 % për subjektin “Shijaku” shpk.

Në pikat 1, 2 e 3 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të të prokurimit publik” të ndryshuar, përcaktohet se:

a. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

b. Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton se anëtari i BOE, subjekti Shijaku shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2 të Kpacitetit Ekonomik:

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022-2023-2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, pasi nuk ka paraqitur kopje të bilancit (pasqyrave financiare) vitit 2024 të konfirmuara nga Administrata Tatimore dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar për vitin 2024. Referuar xhiros vjetore të vitit 2024, rezulton se ky subjekt ka rregjistruar një xhiro vjetore për vitin 2024 prej 8,246,006,389 lekë, ndërsa referuar Forumlarit Përmbledhës së Vetdeklarimit, rezulton se ky subjekt deklaron një numur mesatar punonjësish gati dhjetëfish më të lartë se numri prej 30 punonjësish në minimum që parashikon neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në këto kushte ky subjekt plotëson dy nga tre kërkesat e nenit 41 gërma "c" të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 dhe ka patur detyrimin të shoqëronte pasqyrat financiare (të cilat duhej të ishin të konfirmuara nga administrata tatimore) me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

c. Anëtari i BOE, subjekti Progres Shkodra shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.6 në raport me përqindjen e marrë përsipër në akt marrëveshjen e datës 09.05.2025. Sipas akt marrëveshjes operatori Progres Shkodra shpk ka deklaruar se do të realizojë 29 % të volumit të punimeve në rast të shpalljes fitues. Nëse i referohemi zërave të punimeve të marra përsipër për tu realizuar nga subjekti Progres Shkodra shpk konstatojmë se ky subjekt do të kryejë zërin: "Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (Ambjente Jashte) 121 m² " dhe "Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (Ambjente brenda, mure, tavane dhe stukime)" 1,370 m², por nuk ka deklaruar në Forumularin Përmbledhës së Vetdeklarimit se disponon një "**Bojaxhi**", ka deklaruar se do të realizojë zërin e preventivit "Shtrese me pllaka grez importi 40 x 40 cm" 676 m² dhe "Shtrese pllaka mermeri t = 20 mm" 13.52 m, por nuk ka deklaruar se disponon një "**Pllakashtrues**"; ka deklaruar se do të realizojë zërin e punës: "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama" 403 m², por nuk ka deklaruar se disponon minimumi një "**Hidroizolues**".

Pika 3 e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 përcakton se kërkesat profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret operatori Progres Shkodra shpk ka marrë përsipër kryerjen e zërave të punimeve për të cilët nuk ka deklaruar se disponon minimumi 1 "Bojaxhi", 1 "Pllakashtrues" e 1 "Hidroizolues". Referuar përqindjes në pjesëmarrje 29 % si dhe numrit total të specialistëve të kërkuar në ikën 2.3.6 në të cilën kërkohen në total 15 specialistë e 4 punëtorë,

në total 19, subjekti Progres Shkodra shpk sipas përqindjes së marrë përsipër por dhe zërave të punimeve duhej që të dispononte minimalisht 5.5 punonjës.

d. Nga vlerësimi i Formularit Përmbledhes së Vetdeklarimit të subjektit “BEAN” shpk, mbështetes i operatorit “Shijaku” shpk rezulton se prej tij nuk është plotësuar i saktë dhe nuk është deklaruar asnjë e dhënë e identifikueshme lidhur me rubrikat e Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit. KVO konstaton qe subjekti mbështetës “BEAN” shpk nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 209/2025, date 07.02.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

e. Anëtar i BOE, Shijaku shpk ka deklaruar se si inxhinier Drejtues Teknik të deklaruar në licencën e shoqërisë ka z. Elvis Zeqo, gjithashtu ka dorëzuar dhe një deklaratë në mbështetje të pikës 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, se në rast të shpalljes fitues inxh. Elvis Zeqo do të jetë i disponueshëm me kohë të plotë për zbatimin e punimeve objekt prokurimi.

Nga verifikimet e bëra rezulton se z. Elvis Zeqo me profesion inxh. Hidroteknik me nr. Personal I50702099E, është i punësuar pranë subjektit “Tirana Parking” sha me nipt L52403451V, i cili është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.

Në pikën 2 të kreut “IV” të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, parashikohet se:

Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. Në këto kushte drejtuesi teknik i subjektit Shijaku shpk ndodhet në kushtet e papajutueshmërisë me detyrën e tij.

f. OE Progres Shkodra shpk dhe Shijaku shpk nuk plotësojnë kriterin e pikës 2.2.3 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar pasi nuk kanë dorëzuar një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se: kanë paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

2.B.O.E “AHK-NY”sh.p.k M22302033N & “B-93”sh.p.k J62903508R

1.Operatorët ekonomikë kanë marrë pjesë si Bashkim i Përkohëshëm i Operatorëve ekonomikë formalizuar me Kontraten e Bashkepunimit të datës 12.05.2025 nënshkruar mes tyre.

Sipas kësaj akt marrëveshje palët e mësipërme kanë rrënë dakort që të marrin pjesë në këtë bashkim dhe të realizojnë zërat e punimeve 50.47 % për subjektin “AHK-NY” shpk dhe 49.53 % për subjektin “B-93” shpk.

Në pikat 1, 2 e 3 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të të prokurimit publik” të ndryshuar, përcaktohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

-OE “AHK-NY” shpk dhe “B-93” shpk nuk plotësojnë kriterin e pikës 2.2.3 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar pasi nuk kanë dorëzuar një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se: kanë paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

- Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton se anëtari i BOE, subjekti “AHK-NY” shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2 të Kpacitetit Ekonomik:

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të balanceve të viteve 2022-2023-2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, pasi nuk ka paraqitur kopje të bilancit (pasqyrave financiare) të vitit 2022, 2023 dhe 2024 të konfirmuara nga Administrata Tatimore.

- Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton se anëtari i BOE, subjekti “B-93” shpk nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2 të Kpacitetit Ekonomik:

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të balanceve të viteve 2022-2023-2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet

e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, pasi nuk ka paraqitur kopje të bilancit (pasqyrave financiare) të vitit 2022 dhe 2024 të konfirmuara nga Administrata Tatimore.

-BOE "AHK-NY" shpk dhe "B-93" shpk nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik të DT-ve, sipas të cilës është kërkuar:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, të paisur me kontratë pune (të vlefshme), diplomë leshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore/organe/institute të akredituar, ose të kontraktuar posaçërisht për të realizuar këto kontratë në rastin kur makineritë janë me qera për manovratorët, ku nga këta të jenë të paktën:

▪ Teknik Ndertimi	1 (nje)
▪ Elektracist	1 (nje)
▪ Saldator	1 (nje)
▪ Hidraulik	1 (nje)
▪ Bojaxhi	1 (nje)
▪ Murator/Suvatues	2 (dy)
▪ Pllakashtrues	1 (nje)
▪ Hidroizolues	1 (nje)
▪ Specialist Ndertimi	1 (nje)
▪ Karpentier	1 (nje)
▪ Hekurkthyes	1 (nje)
▪ Punetore të thjeshtë	4 (kater)
▪ Shofer	2 (dy)
▪ Manovratore / Eskavatoriste / Automakinist	1 (nje)

Për stafin teknik të mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- diplomën e shkollës/deshmi nga organe/institute të akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjësve të mësipërm;

Ne formularin përmbledhës të vetdeklarimit, deklarata B, op. ekonomike duhet të deklarojnë për punësit e mësipërm, profilin e punës, numrin e kontratave individuale të punës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Nga verifikimi dhe vlerësimi i Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit të dorëzuar nga operatori "AHK-NY" shpk dhe "B-93" shpk, rezulton se asnjë prej dy anëtarëve nuk ka deklaruar disponimin e stafit të punonjësve me specialitetet përkatëse sikurse është kërkuar në pikën 2.3.6. Mungesa e deklarimit të punonjësve sipas kërkesave të kriterit 2.3.6 e bën ofertën e dorëzuar nga ky BOE automatikisht të skualifikueshme.

-BOE "AHK-NY" shpk dhe "B-93" shpk nuk plotëson pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të DT-ve, sipas të cilës është kërkuar:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

,pasi asnjë prej dy anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh nuk ka dorëzuar deklaratat respektive mbi përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve në objekt.

-BOE “AHK-NY” shpk dhe “B-93” shpk nuk plotëson pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik të DT-ve, sipas të cilës është kërkuar:

Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton, 2 copë.

Referuar vetdeklarimeve të të dy operatorëve në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit, rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar disponimin e 2 kamionëve veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton. Subjektet kanë deklaruar se disponojnë kamion por pa përcaktuar kapacitetin e kërkuar mbajtës.

Është kërkuar: Betoniere 0.5m³, 2 copë !

Referuar vetdeklarimeve të të dy subjekteve në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit rezulton se është deklaruar disponimi i betoniereve por pa përcaktuar kapacitetin e kërkuar prej 0.5 m³.

Gjithashtu, nëse i referohemi përqindjes së deklaruar në këtë Bashkim operatorësh për subjektin AHK-NY shpk 50.47 % si dhe zërave të punimeve të deklaruara në preventiv për të kyer nga ky subjekt në rast të shpalljes fitues, rezulton se kriteri i pikës 2.3.7 nuk nuk plotësohet fare nga ky operator në përputhje me përqindjen e deklaruar.

Në pikën 3 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “RRP” të ndryshuar, parashikohet se: ...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar deklaratimeve të bëra nga subjekti AHK – NY shpk në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit mbi disponimin e mjeteve dhe makinerive, rezulton se ky subjekt ka deklaruar se disponon vetëm 5 kamiona (pa përcaktuar kapacitet mbajtës) dhe 2 eskavatora.

Ndërsa referuar detyrimit mbi disponimin e pajisjeve dhe mjeteve sipas kriterit të pikës 2.3.7 në raport me përqindjen e marrë përsipër nga ky operator, nuk rezulton i deklaruar asnjë prej pajisjeve dhe makinerive të kërkuara në pikën 2.3.7.

3. “Nika”sh.p.k J76705047U

Oferta është anomalisht e ulët Pas vlersimit të bërë nga KVO ku rezulton se plotësojnë kushtet për kualifikim vetëm 2 op.ekonomik bazuar në pikën 4 të nenit 82 të VKM br.285 ,date 19.05.2024 ku parashikohet se pas korrigjimit të gabimeve aritmetike,kvo verifikon nëse oferta e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në DST.Në rastin konkret kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta në përputhje me nenin 92 të LPP-se oferta vlersohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur me shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur.Referuar fondit limit të procedurës së prokurimit zbatohet formula e mëposhtme :

Fondi Limit 20,784,056

ZM=FL-25%

20,784,056 -25% =15,588,042

Cdo oferte që është poshtë vlerës 15,588,042 është anomalisht e ulët dhe skualifikohet në kërkesë rast pa i kërkuar sqarim apo argumentim pasi në përputhje me nenin 93 të ligjit nr.162 ,date 23.12.2022”LPP” të ndryshuar pasi kjo procedurë bën pjesë në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar.

4. “Asi Invest”sh.p.k M01927023H

Nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.3 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar pasi nuk ka dorëzuar një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se: ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Operatori Asi Invest shpk nuk plotëson kriterin për dorëzimin e plotësuar të Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit. Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit të dorëzuar në SPE nga Asi Invest shpk rezulton se ky operator ekonomik ka dorëzuar një Formular Përmbledhës Vetdeklarimi (Shtojca 8) të ndryshëm nga ai i publikuar bashkë me dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi. Konkretisht Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit të dorëzuar nga Asi Invest shpk nuk ka të përfshirë në seksion Pjesa I: SHKAQET E PËRJASHTIMIT. A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, rubrikën: “Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate”.

Përdorimi i një Formulari Përmbledhës Deklarimi i cili është i ndryshëm nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor pjesë e dokumentave standarte të tenderit, përbën shkak për skualifikimin e ofertës.

Gjithashtu referuar atij Formulari Përmbledhës së Vetdeklarimit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik Asi Invest shpk rezulton se për rubrikën: *“Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi”*, operatori ekonomik nuk ka përcaktuar adresën e institucionit lëshues që

provon nëse operatori është ose jo i denuar sipas pyetsorit të kësaj rubrike ose llojin e dokumentit që provon një pohim të tillë. KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 209/2025, date 07.02.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “OUEN”sh.p.k me adrese Lagjia Shemri,rruga nacionale shemrikukues km2,zona kadastrale nr.3335,numir pasurise 593/1, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 20,601,321.39 (Njzetmilion e gjashtëqinde e njemije e treqinde e njetet e nje pike tridhjetë e nente) leke pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Rrok DODAJ